O robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar Vetes padrejtësinë dhe e kam bërë të ndaluar edhe ndërmjet jush, andaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit

Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se Profeti ﷺ tregon se Allahu i Lartësuar thotë: "O robërit e Mi! Unë ia kam ndaluar Vetes padrejtësinë dhe e kam bërë të ndaluar edhe ndërmjet jush, andaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit. O robërit e Mi! Të gjithë jeni të devijuar, përveç atij që Unë e udhëzoj, andaj më kërkoni udhëzim, që t'ju udhëzoj. O robërit e Mi! Të gjithë jeni të uritur, përveç atij që Unë e ushqej, andaj më kërkoni ushqim, që t'ju ushqej. O robërit e Mi! Të gjithë jeni të zhveshur, përveç atij që Unë e vesh, andaj më kërkoni veshmbathje, që t'ju furnizoj me të. O robërit e Mi! Ju bëni gabime natë e ditë, ndërsa Unë i fal të gjitha mëkatet, andaj më kërkoni falje, që t'ju fal. Ju kurrë nuk do të arrini të më bëni dëm e as që do të keni mundësi të më bëni dobi. O robërit e Mi, edhe po qe se të gjithë ju, i pari e i fundit, përfshirë njerëzit e xhinët, bëheni si njeriu më zemërmirë prej jush, kjo gjë aspak nuk do ta shtonte sundimin Tim. O robërit e Mi, edhe nëse të gjithë njerëzit e xhinët, fillim e mbarim, bëheni si njeriu më zemërprishur nga mesi juaj, kjo gjë as që do të pakonte sundimin Tim. O robërit e Mi, në qoftë se të gjithë njerëzit e xhinët, fund e krye, tubohen në një vend, më drejtohen me kërkesa e Unë i jap gjithsecilit atë që kërkon, kjo nuk do të pakësonte asgjë nga ajo që gjendet tek Unë, respektivisht aq sa përthith gjilpëra kur futet në det. O robërit e Mi! Vërtet ato janë veprat tuaja, të cilat i ruaj e më pas jua shpërblej, kështu që, kushdo që gjen mirë, le ta falënderojë Allahun, ndërkaq, ai që gjen keq, le ta qortojë vetëm vetveten."

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith na sqaron se Allahu i Lartmadhëruar ia ka ndaluar padrejtësinë Vetvetes dhe e ka bërë të ndaluar te krijesat e Tij, në mënyrë që askush të mos i bëjë padrejtësi ndokujt tjetër. Të gjithë njerëzit janë të devijuar nga rruga e vërtetë, përveç atyre që i udhëzon Allahu e u jep sukses, kështu që, atij që i kërkon Allahut udhëzim, Ai i jep sukses dhe udhëzim. Njerëzit janë të varfër dhe nevojtarë për Allahun në të gjitha nevojat e tyre, andaj, kushdo që i kërkon Allahut, Ai ia plotëson e nevojat dhe i mjafton. Ata mëkatojnë gjatë ditës e natës dhe Allahu i Lartësuar ia mbulon e ia fal robit kur ai kërkon falje. Ata nuk kanë mundësi aspak t'i bëjnë dëm e as dobi Allahut. Ata edhe sikur të bëheshin si njeriu më zemërmirë, kjo gjë aspak nuk do ta shtonte sundimin e Allahut. Ata edhe sikur të bëheshin si njeriu më zemërprishur, kjo gjë nuk do të pakonte sundimin e Tij, sepse janë të dobët e të varfër për Allahun; nevojtarë për Të në çdo gjendje, kohë e vend, e Ai është i

Vetëmjaftueshmi, i Latësuari. Nëse ata do të qëndronin në një vend, njerëzit dhe xhinët, fund e krye, duke e lutur Allahun dhe Ai do t'i jepte secilit prej tyre atë që kërkon, kjo nuk do të pakësonte asgjë nga ajo që ka Allahu, sikurse një gjilpërë, nëse futet në det dhe pastaj hiqet, nuk do të pakësonte asgjë prej detit. Kjo është për shkak të vetëmjaftueshmërisë së përsosur të Allahut të Lartësuar. Allahu i Lartësar i ruan veprat e robërve, ua llogarit dhe i shpërblen për to në Ditën e Kiametit. Andaj, kushdo që e gjen shpërblimin për punën e tij të mirë, le ta falënderojë Allahun që i dha sukses t'i bindet Atij, e, kushdo që e gjen shpërblimin e punës së tij, të jetë diçka tjetër, atëherë le të mos qortojë askënd pos vetes - shpirtit, i cili është i prirur për të keqen, gjë që e dërgoi në humbje.

https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/4810

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY
لجنة الدعوة الإلكترونية
EDC E-Da'wah Committee